

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 440/1 prot.

Shkodër, më 01.07.2023

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 51, datë 30.06.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 29, neni 37, pika 1, shkronja “c”, neni 54, shkronja “dh”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 30, shkronja “gj”, neni 41, pika 2, të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III, të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 4109 prot., datë 05.07.2023 “Mbi dokumentacionin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, datë 30.06.2023”, shqyrtoi *VKB Vau Dejës nr. 51, datë 30.06.2023 “Për një ndryshim në VKB nr. 37, datë 28.04.2023 “Për dhënien e ndihmës financiare familjes së z. Faik Dan Shegaj që i është dëmtuar banesa si pasojë e zjarrit të rënë me dt. 22.03.2023, sipas Vertetimit për rënie zjarri të MZSH nr. 3, datë 03.04.2023”*, me ndihmë financiare z. Faik Dan Shegaj në shumën prej 216.173 lekë, nga programi 3280 “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”, nga buxheti i vitit 2023 të Bashkisë Vau Dejës.

Për sa trajtuar, pas rishikimit, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 51 datë 30.06 2023

Rishikim VKB Nr.37 “Mbi dhënien e ndihmës financiare familjes së z.Faik Dan Shegaj që i është dëmtuar banesa si pasoje e zjarrit të rënë me dt.22.03.2023 “

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:


Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar,Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi nr.3 dt.28.12.2016 “Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave , për vitin 2016, si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër “Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” si dhe në shkresën e AKMC Nr. 86/6 dt.27.03.2023”Mbi fondin e Kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” dhe shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë Nr.4234/1 dt.27.03.2023 “Mbi çeljen e fondit të Kushtëzuar për Bashkinë Vau-Dejës” si dhe pas shqyrtimit te projekt vendimit Nr.3 dt.18.04.2023, paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile , ku propozohet dhënia e ndihmës financiare për shtetasin **Faik Dan Shegaj** banorë i fshatit **Melgushë** të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës. Pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të votave,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I:

- 1. Miratimin** e proces verbalit të konstatimit të gjendjes dhe dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve, të hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e kryetarit te Bashkisë Nr.158 prot dt.06.04.2023 në vlerën totale **432.347** (katërqinde tridhjetë e dy e treqind e katërdhjetë e shtatë) lekë për shtetasin **Faik Dan Shegaj** banorë i fshatit Melgushë të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës .
- 2. Miratimin** e dhënies së ndihmës financiare për shtetasin **Faik Shegaj** banorë i fshatit **Melgushë** të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës me shumën **216.173** (dyqind e gjashtëmbëdhjetëmije e njëqind e shtatedhjetë e tre) lekë në masën **50%** të vlerës totale të dëmit për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga djegia e saj me dt.22.03.2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



3. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.
4. **Burimi i financimit :**Fondi i kushtëzuar i planifikuar në artikullin 604 bazuar në shkresën e AKMC Nr. 86/6 dt.27.03.2023”Mbi fondin e Kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” si dhe në shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë Nr.4234/1 dt.27.03.2023 “Mbi çeljen e fondit të Kushtëzuar për Bashkinë Vau-Dejës.
5. Ngarkohen Drejtorja e Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe finances) për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar).

ZV/KRYETAR

Paola Pleshaj

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Arditur Çelaj

Miratuar me 22 vota

Vota Pro 21

Vota Kunder -

Vota Abstenim 1 (14%)

Zbardhur me datë 05.07.2023

